VENDIM
Nr. 195, datë 22.9.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "ALBGAZ" SHA, PËR SHTYRJE TË AFATIT TË VENDIMMARRJES FINALE TË BORDIT TË ERE-s, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALBGAZ" SHA, NË AKTIVITETIN E OPERIMIT TË HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 16, pika 12, neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; nenit 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44/2015, si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.9.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 122/1 prot., datë 13.9.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi "Kërkesën e shoqërisë 'Albgaz' sh.a. për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s, për licencimin e shoqërisë 'Albgaz' sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 190, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.
- Në vijim, ERE, me vendimet nr. 43, datë 6.3.2020, nr. 119, datë 17.7.2020, nr. 179, datë 4.11.2020, vendosi për zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Albgaz" sh.a. për licencimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.
- Për shkak se subjekti parashtroi në ERE se shumë projekte fizibiliteti u pezulluan për një kohë më të gjatë se sa ajo e parashikuar për arsye të pandemisë COVID-19, dhe si e tillë, shoqëria "Albgaz" sh.a. nuk disponon ende të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ERE.
- ERE është informuar se është në proces kryerja e një studimi për hapësirat e depozitimit të gazit natyror dhe përfundimi i këtij studimi do të mundësojë edhe plotësimin e dokumentacionit specifik për licencën e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.
- Duke qenë se në kërkesën e shoqërisë për shtyrje të afatit nuk është dokumentuar sa dhënë argumente, në lidhje me pamundësinë e plotësimit të dokumentacionit të munguar në aplikim, vlerësohet që shoqërisë "Albgaz" sh.a., t'i lihet detyrë që brenda datës 20.1.2022, të depozitojë në ERE dokumentacionin apo argumentet justifikuese, me qëllim që të vlerësohet shtyrja e afatit për një periudhë më të gjatë sipas kërkesës së saj.
- Kërkesa e "Albgaz" sh.a. rezulton e depozituar brenda afatit të përcaktuar në nenin 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, i cili përcakton, se:

"3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shoqëria "Albgaz" sh.a., brenda datës 20.1.2022, të depozitojë në ERE dokumentacionin apo argumentet justifikuese (mbi të gjithë dokumentacionin e konstatuar si të munguar në aplikim) me qëllim që të vlerësohet shtyrja e afatit sipas kërkesës së shoqërisë.

2. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 20.9.2021.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Albgaz" sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti